

## POZICION VAKANT

**Profili i kompanisë:** Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një ndër grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshmet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe manaxhimin e pasurive të paluajtshme, tregtinë me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikë, etj. Gjeografikisht Grupi është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Mali i Zi dhe Vendet e Ulëta duke punësuar më shumë 5'000 persona. Grupi BALFIN është në rritje të vazhdueshme dhe synon përmirësimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të komuniteteve nëpërmjet zhvillimit ekonomik, rritjen e punësimit dhe investimeve sociale. SPAR Albania është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit "SPAR".

**Pozicioni:** Supervizor/e Logjistike

**Grada:** 8

**Departamenti:** Logjistike

**Vendndodhja:** Zyra Qendrore

**Përmbledhje e pozicionit:** Ndjek të gjitha procedurat si dhe mban nën kontroll dhe buxhet stokun dhe shpenzimet e logjistikës për pjesën e importit.

### Detyra dhe përgjegjësi:

- Mbajtja e shpenzimeve të logjistikës në vlerat e përcaktuara sipas buxhetit;
- Optimizimi i stokut të TLP-së për të siguruar furnizimin e marketeve;
- Ndjekja e procesit të bërjes së porosisë për produktet PL, sigurimi i stokut optimal VS shitjeve, ndjekja e skadencave të tyre;
- Ndjekja e procedurave të zhdoganimit që nga porosia tek furnitori e deri në hyrjen në magazinë dhe shpërndarjen e tyre në destinacionet përkatëse;
- Mbajtja e stokut në nivele optimale bazuar në strategjinë ose parametrat e stokut të përcaktuara nga kompania;
- Menaxhimi i nivelit të stokut dhe sasisë së produkteve të porositura tek furnitorët duke u siguruar që porositë të realizohen bazuar në nivelin aktual të stokut dhe duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me Departamentin e Blerjeve;
- Mbajtja e kontakteve me furnitorët në lidhje me dokumentacionin që këta të fundit duhet të disponojnë për të gjitha produktet në qarkullim;
- Përpilimi i raporteve ditore mbi produktet që janë gjendje në magazinë;
- Përgatitja e raportit mbi nivelin e stokut dhe analiza e koeficientit të turnoverit;
- Analizimi i porosive që vijnë nga dyqanet dhe bën sygjerimet e nevojshme duke patur parasysh parametrat e stokut (minimal, optimal dhe maksimal)
- Përgjegjës për qarkullimin e stokut bazuar në kërkesat e Departamentit të Blerjeve;
- Implementimi i termave të paracaktuara, prokurimi i sasisë së stokut të kërkuar në cdo kohë në mënyrë që të plotësojë kërkesat e dyqanit dhe konsumatorëve;
- Ndjekja dhe analizimi i qarkullimit të produkteve me afat të shkurtër skadence dhe procedurat e menaxhimit të tyre;

**Edukimi:** Të zotërojë diplomë universitare.

**Eksperiencat e punës:** Të ketë përvojë pune në pozicione te ngjashme minimumi 3 vite.

**Kualifikime të tjera:**

- Aftësi të mira kompjuterike të paketës Microsoft Office;
- Njohuri të mira të gjuhës Italiane dhe asaj Angleze.

**Aftësi të tjera:**

- Të jetë person i motivuar dhe ambicioz;
- Aftësi të shkëlqyera të menaxhimit të kohës;
- Aftësi të mira të punës në grup;
- I aftë të negociojë dhe bashkëpunojë me Departamentet e tjera

**Kushtet e punës:** Ofrohet pagë konkurruese.

**Mënyra e aplikimit:** Kandidatët e interesuar janë të lutur të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit [hr@spar.al](mailto:hr@spar.al) duke përcaktuar në subjekt pozicionin, nëpërmjet faqes së Web-it ose nëpërmjet postës, në adresën: Spar Albania, Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

**Afati i dorëzimit:** 27/08/2020

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*